



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**PËR PUNONJËSIT E NJËSISË SË VLERËSIMIT
TË NEVOJAVE DHE REFERIMIT**



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



PAKETA LIGJORE

PËR PUNONJËSIT E NJËSISË SË VLERËSIMIT TË NEVOJAVE DHE REFERIMIT

AKRONIME

ETN	Ekipi Teknik Ndërsektorial
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
KVDHF	Koordinatori Vendor i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PIM	Plani Individual i Mbrojtjes
PMF	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës
UM	Urdhri i Mbrojtjes
UMM	Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes
UMPMM	Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
PËR TË GJITHA KATEGORITË E PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE NGA NJVNR.....	8
TË RRITURIT ME PROBLEME SOCIALE, EKONOMIKE	10
PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	13
FËMIJË	14
VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE.....	21
TË MOSHUAR	24
VIKTIMA TË TRAFIKIMIT	25
MOSDISKRIMINIMI DHE TË DHËNAT PERSONALE	25

HYRJE

Paketa ligjore për Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NVNVR) u përgatit në zbatim të Programit “Fuqizojmë Komunitetin (ICR)”, financuar nga USAID dhe zbatuar nga UNDP Shqipëri, në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkitë Durrës, Kurbin, Lezhë. Paketa është një mjet pune për ekipin e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit¹.

NVNVR ka këto detyra: (i) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; (ii) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë; (iii) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim për punësim, për pagesat sociale në të holla; (iv) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; (v) bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; (vi) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; (vii) mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; (viii) hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar; (ix) kryen funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Siç shihet nga detyrat e përshkruara më lart ekipi i NVNVR-së në territorin e njësisë administrative (administratori shoqëror-punonjësi social-punonjësi i mbrojtjes së fëmijës) duhet të punojë për çdo individ në nevojë për mbrojtje apo përkujdesje. Në praktikën e punës ata duhet të zbatojnë legjislacionin kombëtar, i cili është i gjerë në këtë fushë, pasi edhe grupet në nevojë për shërbime janë të ndryshme dhe shpesh adresimi i nevojave të tyre është ndërsektorial. Në kushtet që ky ekip duhet të punojë në grup ata duhet të kenë një njohje të njëjtë dhe të plotë të paketës së legjislacionit për çdo grup në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Kjo paketë ligjore adreson në mënyrë praktike këtë nevojë të NVNVR-së.

Paketa **është strukturuar sipas përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror** në referencë të nenit 6 të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë paketë nuk përfshihen ligjet dhe aktet nënligjore që lidhen me programin e pagesave kesh. Paketa ligjore e përgatitur do të duhet të rishikohet vazhdimisht nga struktura përgjegjëse e Bashkisë për të reflektuar ndryshimet që ndodhin në aktet ligjore dhe nënligjore për secilin prej grupeve të specifikuar në ligj (si më lart).

¹ Kjo paketë ligjore u përgatit me ekspertizën e Znj. Etleva Bisha.

PËR TË GJITHA KATEGORITË E PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE NGA NJVNR

- *Familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;*
- *Personat me aftësi të kufizuara;*
- *Të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;*
- *Vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;*
- *Të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;*
- *Të moshuarit në nevojë.*

Njohja e **ligjit**² është e rëndësishme nga të gjithë punonjësit e NJVNR. Ligji është pasuar nga një numër aktesh nënligjore, që shtjellohen sipas grupeve në nevojë përgjatë kësaj Pakete Ligjore. Një nga elementët e tij që duhet nënvizuar është njohja e përgjegjësisë për zbatimin e sistemit të shërbimeve shoqërore (**nenet 30-38**) dhe veçanërisht **neni 37: Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore.**

LIGJ 121/2016
“Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Theksojmë gjithashtu: Bazuar në nenin 5 të këtij ligji të drejtën për të përdorur këto shërbime e kanë:

- Individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera

2 <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2017/02/ligj.1212016.pdf>

- Individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.
- Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren nga shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët me banim në Republikën e Shqipërisë.
 - Personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e kujdesit shoqëror njësoj si shtetasit shqiptarë, bazuar në dokumentacionin përkatës, të përgatitur për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas legjislacionit në fuqi për azilin.

Bazuar në nenin 7 të ligjit ***nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror:***

- Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;
- Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;
- Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;
- Personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës

VKM 518³ duhet të njihet e konsultohet vazhdimisht nga NJVNR, pasi përcakton procedurat dhe dokumentacionin për të përfituar shërbime nga individët në nevojë. Theksojmë veçanërisht:

- Për çdo individ në nevojë për të marrë shërbim komunitar ose rezidencial vlerësimin e nevojave e bën punonjësi social, i cili pasi ka vlerësuar tipin e shërbimit që do ti ofrohet individit përgatit ***dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në kreun 4 të VKM.***
- Për të mundësuar ***përfshirjen e individit*** në nevojë në shërbimin komunitar ose rezidencial ***punonjësi social duhet të ndjekë procedurat që përcaktohen në kreun 3 të VKM.***

VKM
nr. 518, date 4.9.2018
“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”

Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror⁴ shërben për:

a) Ndërtimin e një mekanizmi funksional të referimit, të ndjekjes, të monitorimit dhe vlerësimit të rastit; b) Identifikimin e rasteve, këshillimin dhe hartimin e planeve individuale të përkujdesjes nga njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, në përputhje me Ligjin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; c) Referimin në shërbime specifike sociale të nivelit vendor, rajonal apo kombëtar.

Njohja e Vendimit është **shumë e rëndësishme për punonjësin social**, pasi, për çdo rast të referuar apo menaxhuar, punonjësi **ka detyrimin të hedhë në sistem të dhënat parësore**.

Regjistri përmban të dhëna parësore (pika 8.1 e Vendimit) dhe të dhëna dytësore (pika 8.2 e Vendimit), ku këto të fundit janë të dhëna që vijnë nga baza të dhënash të institucioneve të ndryshme, si: zyrat e punës, tatimet etj., etj.

Me rëndësi për punonjësin social është **pika 8.1**: Të dhëna parësore për Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror, janë të dhënat për: **a) Raste të unifikuara e të referuara për përfitimin e shërbimit të kujdesit shoqëror; b) Përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror; c) Verifikimin e të dhënave të rastit të unifikuar e të referuar për përfitimin e shërbimit të kujdesit shoqëror në rrugë elektronike, nëpërmjet ndërveprimit të bazës së të dhënave shtetërore ose komunikimit me institucionet/organet e tjera apo intervistimit të përfituesit të shërbimit të kujdesit shoqëror; ç) Dosjen elektronike të rastit të unifikuar e të referuar për përfitimin e shërbimit të kujdesit shoqëror, ku do të skanohet i gjithë dokumentacioni në letër (fizik) i mbledhur;**

TË RRITURIT ME PROBLEME SOCIALE, EKONOMIKE

Ligj 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”⁵ përcakton ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Ai rregullon marrëdhëniet e financimit e

4 <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2034/VKM%20nr:%20136,%20date%207.3.2018.pdf>

5 <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/asisstenca-sociale-ne-kuvend-1-2.pdf>

të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri duke përfshirë llojet e dhe kriteret e përfitimit, kategoritë përfituese dhe procedurat përkatëse.

Ligji⁶ përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur rregullohen nga legjislacioni i posaçëm.

LIGJ Nr. 15/2019
“Për Nxitjen e Punësimit”

Me rëndësi për tu njohur janë **Programet Aktive të Tregut të Punës (kreu III), nenet 6-12, Fondi Social i Punësimit** (neni 21) që lidhet me personat me aftësi të kufizuara.

VKM 882⁷ synon riintegrimin social të familjeve të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike përmes ngritjes dhe funksionimit të një mekanizmi që përfshin Bashkinë, përmes strukturës përgjegjëse, Zyrën e Punës dhe Drejtorinë Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

VKM
nr. 882, datë 24.12.2019
“Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”

Në përputhje me këtë VKM ekipi i përbashkët i ngritur duhet të jetë përgjegjës për a) identifikimin dhe referimin e qytetarëve që përfitojnë ndihmë ekonomike për t'u trajtuar me programe të aftësisimit dhe të formimit profesional; b) plotësimin e planeve individuale të shërbimeve sociale, i cili, ndër të tjera, përmban të dhëna për individin dhe nevojat për shërbime sociale që përbëjnë pengesë për punësim, duke përfshirë ato shëndetësore, sociale e të strehimit; c) plotësimin e planeve individuale të punësimit bazuar në mundësitë aktuale të masave aktive të tregut të punës (punë publike, subvencion page, internship etj.) d) asistimin dhe ndjekjen e rasteve, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshtatshme; dh) ndjekjen e protokolleve të trajtimit me programe të këshillimit, të aftësisimit, të ndërmjetësisimit dhe të punësimit; e) referimin dhe trajtimin me programe sociale, përfshirë ato të strehimit, social, shëndetësore, si edhe programe të tjera që kanë në focus fuqizimin e individit e të familjeve; ë) identifikimin e individëve që nuk janë regjistruar si punëkërkuar të papunë, informimin e tyre për procedurën që duhet të ndjekin dhe orientimin e referimin e tyre; f) identifikimin e raportimin e rasteve që janë çregjistruar për arsye punësimi, përfshirë pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit apo kanë humbur statusin e punëkërkuar të papunë për arsye të refuzimit të shërbimeve dhe të programeve të ofruara nga zyra e punësimit; g) identifikimin e raportimin e rasteve që nuk janë regjistruar në zyrat e punës si punëkërkuar të

6 https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/ligj-nr-15-dt-13.3.2019_nxitja-e-punesimit.pdf
7 <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/vendim-2019-12-24-882.pdf>

papunë apo që nuk paraqiten në takimin e përcaktuar; gj) shkëmbimin e informacionit me të dhënat e anëtarëve aktivë në moshë pune të familjeve nga skema e ndihmës ekonomike të regjistruar pranë zyrave të punësimit që janë ndërmjetësuar për punë dhe s'kanë përfituar nga programet aktive të tregut të punës; i) raportimin periodik lidhur me mbarëvajtjen e procesit pranë mekanizmit qendror; j) raportimin për fillimin e zbatimit të planit individual të veprimit për personat në moshë aktive pune, përfitues të ndihmës ekonomike, e cila do të konsiderohet si çasti i daljes nga skema e ndihmës ekonomike dhe e përfundimit të së drejtës së përfitimit nga kjo skemë; k) shkëmbimin e të dhënave në kohë reale nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informacionit dhe/ose në mënyrë shkresore;

Urdhëri⁸ është i rëndësishëm pasi ngre mekanizmin ndërsektorial dhe përcakton procedurat e përbashkëta që ndiqen për të nxitur punësimin e individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Udhër i Përbashkët
i Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 148, datë 28.02.2022 "Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për referimin për punësim dhe integrim social të individëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike"

Ligji⁹ përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin

LIGJ Nr.22/2018
"Për Strehimin Social"

e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Ky ligj është i rëndësishëm për programet sociale, pasi përgjithësisht familjet në nevojë kanë të nevojshme ndërhyrje komplekse dhe të koordinuara, mungesat në strehim janë njëra prej tyre. **Përveç njohjes së ligjit, punonjësi social në njësinë administrative duhet të informohet nga struktura e shërbimeve sociale në Bashki mbi llojet e programeve të strehimit që ka të zhvilluara Bashkia**, në mënyrë që të mund të shfrytëzojë këto programe gjatë menaxhimit të rasteve sociale kur është i nevojshëm strehimi.

Ligji përcakton jo vetëm tipet e programeve sociale të strehimit, por për cdo program specifikon përfituesit, sikurse parashikon që Bashkia duhet të hartojë Programin e Strehimit zbatimi i të cilit mundësohte nga fondi i strehimit, i krijuar nga fonde të buxhetit të shtetit, bashkisë, donatorëve etj. **Me rëndësi për punën e punonjësit social janë:**

8 <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/urdhernr148dt280222.pdf>
9 <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/12/ligj-nr-22-dt.-3.5.2018.pdf>

- **Neni 11 Llojet e programeve sociale të strehimit:** a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ; b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU; ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; d) programi për krijimin e banesave të përkohshme; dh) programi i banesave të specializuara;
- **Neni 13 përcakton kushtet e përfitimit të statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit.** Dokumentacioni përgatitet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe dosja përkatëse plotësohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore (me fondet e saj).
- **Neni 65 përcakton detyrimin për vlerësimin e gjendjes social ekonomike të aplikantit, që kryhet nga administratori shoqëror.**

PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ky Ligj¹⁰ ka ofruar një qasje gjithëpërfshirëse mbi aftësinë e kufizuar, duke garantuar nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke bërë të mundur autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, nëpërmjet ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes.

LIGJ Nr. 93/2014
“Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”

Ai gjithashtu përcakton përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë, me qëllim pjesëmarrjen e tyre të barabartë në shoqëri.

Me rëndësi të veçantë për administratorët shoqërorë në këtë Ligj është :

- **Neni 15, në pikën 1** të të cilit përcaktohet se: Organet e qeverisjes vendore emërojnë pranë tyre një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar.
- Ndërsa në **pikën 2** të të njëjtit nen përcaktohet profili i nëpunësit që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar si: punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë se politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuar.

Urdhëri¹¹ është i rëndësishëm pasi parashikon si pjesë të ndërveprimit mes institucioneve edhe krijimin e profilit individual për PAK me qëllim ofrimin në vijim të programeve të nxitjes së punësimit, ndërmjetësimit për punësim, praktikave profesionale etj.

URDHËR I PËRBASHKËT
i Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.211, datë 4,04.2022 “Për miratimin e planit të masave për punësim të personave me aftësi të kufizuara”

Me rëndësi është pika 7 e këtij **Udhëzimi**¹² që përcakton detyrën e administratorit shoqëror për përditësimin e të dhënave në rregjistrë dhe të dhënat që duhet të përditësohen/hidhen.

UDHËZIM
nr. 458, datë 26.07.2022 I Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
“Për procedurën e hedhjes së të dhënave dhe dokumentacionit në arkivën e rregjistrimit elektronik kombëtar të aftësisë së kufizuar”

FËMIJË

- **Fëmija me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;**
- **Fëmija me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.**

Ky **ligj**¹³ përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

LIGJI Nr. 18/2017,
“Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Në tërësi, njohja e këtij ligji është thelbësore për PMF, duke qenë se ai përcakton rolet dhe përgjegjësitë e tij në veçanti. Gjithashtu, ligji shoqërohet edhe me një sërë aktesh nënligjore.

11 <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/urdhernr148dt280222.pdf>

12 <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/udhezim-458-dt-29-07-2022.pdf>

13 <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-%E2%80%9CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BBIJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf>

- Kreu I i ligjit përcakton të drejtat e fëmijës, Kreu II mekanizmat institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Kreu IV përcakton masat për mbrojtjen e fëmijës, Kreu V përcakton mbrojtjen e posaçme, ndërsa i Kreu VI detyrimin për raportim.
- Në veçanti, brenda Kreut II, Nenet 46-51 përcaktojnë **detyrimet e bashkisë dhe PMF në bashki/njësi administrative lidhur me mbrojtjen e fëmijës.**
- Në Kreun IV specifikohet **Plani Individual i Mbrojtjes**, specifikat e të cilit rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe **masat e mbrojtjes, të cilat në këtë ligj shtojnë autoritetin e PMF në marrëdhëniet me gjykatën**

Ky Vendim¹⁴ përcakton:a) **Rregullat dhe procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit** të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;bb) **Mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes**; c) **Financimin e shpenzimeve** për zbatimin e tij, dhe d) **Zbatimin e masave të mbrojtjes.**

VKM Nr. 578, datë 3.10.2018,
“Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”

Ky Vendim duhet të njihet e konsultohet vazhdimisht nga PMF, duke qenë se përcakton shumë nga procedurat e punës së PMF me rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Për herë të parë këto procedura përcaktohen me VKM (përkundrejt përcaktimit me udhëzim të ministrit përkatës), duke rritur rëndësinë e tyre dhe përgjegjësinë e zbatimit nga të gjitha institucionet përkatëse, veçanërisht nga ato që janë pjesë e Grupit Teknik Ndërsektorial.

- Kreu II specifikon **procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit**, sipas **hapave të menaxhimit të rastit** (Neni 5), të cilat përfshijnë: 1. Identifikimin; 2. Raportimin; 3. Vlerësimin fillestar; 4. Vlerësimin e plotë; 5. Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes; 6. Zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e PIM; 7. Mbylljen e rastit.
- Neni 17 specifikon elementet e dosjes individuale të fëmijës, e cila duhet të përmbajë **12 formularë** (dhe informacione të tjera, sipas rastit), që i bashkëngjiten këtij Vendimi.
- Kreu III specifikon **zbatimin e masave të mbrojtjes.**
- Kreu IV specifikon **rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve dhe strukturave** për menaxhimin e rastit.
- Kreu V detajon më qartë se më parë **financimin e shpenzimeve** për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes

Ky Vendim¹⁵ përcakton **rregullat e bashkëpunimit për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës**, ndërmjet:

- a) **Mekanizmave** këshillimorë e koordinues institucionalë;
- b) **Strukturave** për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, dhe c) **Organizatave** jofitimprurëse.

Në veçanti, lidhur me NJMF: Kreu I përcakton fushat e bashkëpunimit dhe angazhimin e mekanizmave institucionalë dhe strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të organizatave jofitimprurëse, ndërsa Kreu III përcakton format e bashkëpunimit mes tyre.

Ky **Vendim¹⁶** përcakton **rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial (GTN) (dhe anëtarëve të ftuar sipas rastit)** për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive apo njësive administrative.

Edhe ky Vendim duhet të njihet e konsultohet vazhdimisht nga PMF, duke qenë se **PMF në nivel njësie administrative (ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie) bën kërkesën për mbledhjen e GTN dhe koordinon mbarëvajtjen e tij.**

NJMF ka detyrimin të identifikojë profesionistët dhe strukturat shërbimofruese në territorin në të cilin ajo vepron dhe ka të drejtë që në mbledhjet e GTN të kërkojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe profesionistëve nga struktura të tjera, sipas nevojave të identifikuar në vlerësimin fillestar të rastit. GTN në nivel bashkie drejtohet nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore ose, në mungesë të tij, nga drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve. GTN në nivel njësie administrative drejtohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës.

VKM

Nr. 148, datë 13.03 2018,

“Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”

VKM

Nr. 353, datë 12.06.2018,

“Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”

¹⁵ <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-148-date-13.3.2018.pdf>

¹⁶ <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-353-date-12.6.2018.pdf>

Vendimi përcakton:

- Rregullat për caktimin e anëtarëve;
- Thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes;
- **Funksionet e GTN në vlerësimin e plotë të rastit, miratimin, zbatimin dhe rishqyrtimin e PIM dhe mbylljen e rastit;**
- Dokumentimin e mbledhjeve.

Ky **Vendim**¹⁷ përcakton procedurat që organizohen dhe kryhen nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për: a) Kontrollin e shkeljes të të drejtave të fëmijës; b) Mospërbushjen e detyrimeve ligjore nga strukturat përkatëse të mbrojtjes së fëmijës, dhe c) Vendosjen e sanksioneve.

VKM
Nr. 91, datë 14.02.2018,
“Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Përmes këtij Vendimi, për herë të parë Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës **mund të fillojë procedurat e kontrollit me nismën e vet** në një larmi rastesh dhe jo vetëm në raste të veçanta të bëra publike. Rrjedhimisht, ky Vendim **forcon rolin e ASHMDF në kontrollin dhe vendosjen e sanksioneve.**

Vendimi specifikon marrjen e këtij roli **në rastet e mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e strukturave përkatëse të mbrojtjes së fëmijës**, pra përfshi NJMF.

Gjithashtu, ky Vendim **lehtëson prezantimin e ankesave të NJMF tek ASHMDF**, në rastin e mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga aktorët relevantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës.

Zbatimi i këtij **Vendimi**¹⁸ kërkon angazhimin e punonjësit social, të punonjësit të mbrojtjes së fëmijës dhe administratorit shoqëror (ky i fundit për financimin e shpenzimeve).

Vendimi përcakton dokumentacionin dhe procedurat që ndiqen për shërbimin e përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare. Shërbimi i përkujdesjes në familje kujdestare është tejet i rëndësishëm për ti dhënë fëmijës pa kujdes të përkohshëm prindëror shërbim në përputhje me interesin për të jetuar në një mjedis familjar dhe shmangur institucionalizimin.

VKM
Nr. 149, datë 13.3.2018
“Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”

17 <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/VKM-Nr-91-dt-14.02.2018.pdf>
18 <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/VKM-nr-149-date-13.3.2018.pdf>

Në mënyrë të veçantë punonjësi social duhet të njohë dhe të zbatojë:

- **Kreu II i Vendimit : kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për evidentimin e familjes kujdestare.**
- **Kreu III : Procedurat e vendosjes së fëmijës në familjen kujdestare.**
- Vendimi shoqërohet edhe me formularët tip që plotësohen si pjesë e përmbushjes së procedurave.

Ky **Vendim**¹⁹ përcakton procedurat për identifikimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, si dhe institucionet përgjegjëse për reagimin e koordinuar për mbrojtjen dhe adresimin e nevojave të viktimave të trafikimit.

VKM
Nr. 499, datë 29.08.2018,
“Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Në secilin prej katër komponentëve:

1. Identifikimin dhe reagimin fillestar; 2. Identifikimin formal; 3. Planifikimin për mbështetje dhe riintegrim; 4. Planifikimin dhe mbështetjen për kthimin vullnetar të asistuar dhe 5. Pritjen e personave shqiptarë të trafikuar, VKM detajon strukturat përgjegjëse dhe procedurat që ndjekin kur viktimat është i mitur apo i rritur.

Në rastin e të miturve, bashkia përfshihet përmes NJMF ose PMF (bashki ose njësi administrative). Në këtë pjesë po përqendrohemi vetëm në rastin kur PMF ka përgjegjësi specifike. Vendimi ka rëndësi të njihet/konsultohet nga PMF, për të qartësuar rolet dhe funksionet e të gjitha institucioneve që janë pjesë e mekanizmit të reagimit që ngre VKM në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

Në fokus të punës së PMF janë veçanërisht:

- **Në faqen 36** të Vendimit sqarohen në mënyrë të detajuar **hapat që duhet të ndjekë PMF në funksion të identifikimit dhe reagimit fillestar** të një të mituri viktimë trafikimi ose viktimë e mundshme trafikimit. Në çdo hap përcaktohen dhe tipat e formularëve që duhet të plotësohen, të cilët gjenden në anekset e Vendimit.
- Të rëndësishme në këtë Vendim, në këndvështrimin e punës së PMF, janë edhe **procedurat që ndiqen për planifikimin për mbështetje dhe riintegrim, të cilat jepen në mënyrë të detajuar në faqen 58 të Vendimit.**

¹⁹ <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20127/VKM%20nr.%20499,%20date%2029.8.2018.pdf>

Ky **Vendim**²⁰ rregullon veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës në rastet kur fëmija dyshohet apo ka kryer vepër penale. Është irëndësishëm për tu njohur e zbatuar pasi përmban procedurat që duhet të ndiqen në raste të tilla si nga Bashkia ashtu edhe nga NJVNR.

VKM Nr. 635, datë 26.10.2018

“Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer vepër penale”

Udhëzuesi²¹ duhet të njihet dhe zbatohet nga e gjithë Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

UDHEZIM

nr. 394, datë 9.5.2019

“Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”

Udhëzuesi përmban procedurat, që duhet të ndiqen për të vendosur fëmijët pa kujdes prindëror në shërbimin e përkujdesjes alternative në familje kujdestare dhe synon të njehsojë rregullat dhe procedurat të cilat duhet

të njihen, ndiqen dhe zbatohen nga të gjitha institucionet publike dhe jopublike që kanë detyrimin ligjor për ofrimin e këtij shërbimi.

Procedurat e detajuara në këtë udhëzim ndiqen si për rastin kur fëmija është vendosur në kujdestari me marrëdhënie gjaku ashtu edhe në familje kujdestare pa lidhje me fëmijën.

Udhëzimi²² është një protokoll pune që synon të standartizojë dhe unifikojë procedurat e veprimit për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin. Njohja dhe zbatimi i tij është i rëndësishëm për PMF pasi jo vetëm udhëzon për veprimet që duhet të ndërmerren nga PMF, të shjeguara me raste dhe situata konkrete, por edhe pse në ankesin e tij jepen modelet e akteve që do ti duhet PMF gjatë menaxhimit të këtyre rasteve. Udhëzimi²³ përcakton procedurat për vendosjen në institucionet e përkujdesit shoqëror,

UDHEZIM

nr. 262 datë 26 Maj 2021

“Për miratimin e metodologjisë së së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”

20 <https://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendimi-Nr.-635-date-26.10.2018-Per-veprimtarine-e-strukturave-per-mbrojtjen-e-femijes-ne-lidhje-me-femijen-nen-moshen-per-pergjegjesi-penale-qe-dyshohet-apo-ka-kryer-veper-penale-1-1.pdf>

21 https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Udh%C3%ABzim_394_09.05.2019.pdf

22 <https://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Urdhezimi-metodologjik-femijet-konflikt-me-ligjin-1.pdf>

23 <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/116>

të fëmijës ndaj të cilit është marrë një masë emergjente mbrojtjeje ose një masë mbrojtjeje për vendosje në përkujdesje alternative.

Udhëzimi duhet të njihet dhe zbatohet nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës për rastet kur për fëmijën është marrë masa emergjente e mbrojtjes.

UDHEZIM

nr. 556 datë 29.7.2019

“Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën ndaj të cilit është marrë masa mbrojtjeje”

Ligji²⁴ përcakton kriteret që duhet të plotësoj një individ për të përfituar statusin e jetimit, si dhe të drejtat që rrjedhin nga ky status.

LIGJ

nr.9233, date 13.5.2004 “Për një shtese të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996

“Për Statusin e Jetimit”

Me rëndësi veçanërisht për punonjësin social: Nenet 1 dhe 2 përcaktojnë kriteret

per individet qe perfitojne statusin e jetimit. Konkretisht personat me moshë nga 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kriteret: **a) të lindurit jashtë martesë;b) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit;c) të cilëve me vendim të formës së prere të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton;d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.**

Personat që kanë përfituar statusin para moshës 25 vjecare vijojnë ta përfitojnë statusin edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të veshitura jetese.

Ky **vendim**²⁵ rregullon procedurat që ndiqen për dhenien e statusit të jetimit, si dhe të drejtat që gëzojnë personat që mbajnë këtë status.

VKM

nr.233, datë 10.04.1998

“Për zbatimin e ligjit për statusin e jetimit”

Vendimi përcakton se **statusi i jetimit jepet nga Shërbimi Social Shtetëror, mbi bazën e dokumentacionit që provon plotësimin e kriterëve ligjore për individin kërkues të statusit.**

24 https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/48.-Ligji-Nr.8153-dat%C3%AB-31.10.1996-_Per-statusin-e-Jetimet-.pdf

25 <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/10/VKM-NR.233-Dt.10.04.1998-Jetimit.pdf>

Pikat 4 dhe 5 e VKM përmbajnë listën e dokumentave që dorëzohen pranë njësisë administrative/Bashkisë dhe që më pas i dërgohen për shqyrtim Komisionit të statusit të Jetimit pranë SHSSH.

Pas mbledhjes së Komisionit **SHSSH njofton Bashkinë për vendimin e marrë për çdo individ kërkues të statusit**. Për personat që përfitojnë statusin e jetimit bashkë me njoftimin SHSSH dërgon edhe **dokumentin (librezën) zyrtar që njeh statusin e jetimit**.

Individi përfitues i statusit ka të drejtën e përfitimit të pagesës për efekt të statusit, që e merr pranë Bashkisë/njësisë administrative çdo muaj sipas afatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit.

VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE

Ligji²⁶ synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, në të gjitha forma e saj si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe masa të tjera të nevojshme për viktimat.

Njohja e të gjithë ligjit është me rëndësi për punonjës social, pasi punonjësi social duhet të njoh si institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat detyrues ligjor për masat për mbrojtjen nga dhuna, detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen drejtpërdrejtë me funksionet e punonjës social, sikurse dhe masat mbrojtëse e kushtet për zbatimin e tyre sic parashikohen në këtë ligj.

Theksojmë veçanërisht elementët e ligjit që lidhen drejtpërdrejtë me detyrat e punonjës social:

Neni 7 pika 4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to;

LIGJI
Nr.9669/2006
“Për Masa ndaj Dhunës në
Marrëdhëniet Familjare
(ndryshuar me ligjin nr.9914/2008, nr.10
329/2010, 47/2018, 125/2020)

26 file:///C:/Kontrata%20UNDP%202023-2026/Paketa%20ligjore/Paketa%20ligjore/Ligji%20per-masat-ndaj-dhunes-ne-marredheniet-familjare-te-ndryshuar.pdf

c) koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit

dhe/ose vendqëndrimin të viktimës;

dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Neni 8 Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, në mënyrë të veçantë pika dh) hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.(referoju aneksit 6 të protokollit bazë të mkr: model plani i ndihmës individuale për rastet e menaxhuara nga mkr).

Neni 10 Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje. Neni 13/1 Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

Neni 23 Ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor :

pika 3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligj.pika 3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”

palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. (Referoju Aneks 8 të Protokollit bazë të MKR: Model i Raportit periodik të monitorimit të zbatimit të urdhurit të mbrojtjes). Raporti i monitorimit të zbatimit të masave të UMM/UM përgatitet i veçantë për çdo rast dhe për sa herë kryhet monitorimi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së UMM/UM-së. Kur nga monitorimi i zyrës së shërbimeve sociale në bashki, rezulton kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, njoftohet menjëherë policia pa prituri përmbushjen e afatit 60 ditor të përgatitjes së raportit. Monitorimi i rastit përfshin gjithashtu edhe ndjekjen e progresit në përmbushjen e planit individual të ndërhyrjes mbi shërbimet e planifikuara për viktimën, pra nëse po i përfiton këto shërbime, apo dhe ndikimin që ato kanë pasur në rehabilitimin apo ri-integrimin e rastit.

Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

Punonjësi Social i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve dhe Koordinatori Vendor i menaxhimit të rasteve të dhunës në familje (KVDHF) kanë një rol kyç në procesin e Vlerësimit të Riskut në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. “Vlerësimi i riskut”, faza e menaxhimit të rastit të dhunës në familje, që kryhet menjëherë në mënyrë të shpejtë, pas identifikimit ose raportimit të rastit, me qëllim ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës përmes Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM). Raporti i vlerësimit të riskut shpreh nivelin e rrezikut për rastin konkret dhe sugjeron në proporcion me të, një ose disa nga masat e parashikuara në ligjin nr. 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në fuqi.

Ky **vendim**²⁷ rregullon procedurat standarde bazë për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje, për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

VKM

Nr. 327, Datë 2.6.2021

“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”

E gjithë NJVNR duhet ta njohë këtë VKM e në mënyrë të veçantë detyrat që i janë përcaktuar Komitetit Drejtues, Ekipit Teknik Ndërsektorial, KVDHF. Me shumë rëndësi janë procedurat bazë të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) komitetet

²⁷ <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-0000002.pdf>

drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN); c) KVDH.

Pranë çdo bashkie caktohet KV-ja, në zyra të dedikuara posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni, i cili nuk ka në përshkrimin e punës mbivendosje me detyra të tjera.

Koordinatori Vendor ndërvepron me punonjësin social në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Të rëndësishme janë gjithashtu procedurat që ndiqen gjatë menaxhimit të rasteve të dhunës që përfshihen në kreun III të këtij vendimi.

Janë dy **Protokolle**²⁸ shumë të rëndësishme të cilat standardizojnë veprimet e nevojshme për t'u kryer nga të gjithë anëtarët e MKR-ve për të siguruar një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre ligjore, për mbrojtjen e viktimave dhe vënien e dhunues(e)ve përpara përgjegjesisë.

Protokolli Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor Përmes Mekanizimit të Koordinuar të Referimit (MKR)

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës Seksuale të rritur/rriturit, në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar

TË MOSHUAR

Ky **Vendim i Këshillit të Ministrave**²⁹ përcakton detyra specifike në këndvështrimin e adresimit të nevojave të të moshuarve. Është i rëndësishëm për punonjësit socialë sepse parashikohen masa që krijojnë ndërveprimin e nevojshëm mes strukturave shëndetësore dhe atyre të shërbimit social me qëllim identifikimin e të moshuarve që kanë të nevojshme shërbimet, si dhe adresimin e këtyre nevojave përmes qasjes multisektoriale.

VKM

Nr. 864, Datë 24.12.2019

“Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”

²⁸ <https://shendetesia.gov.al/vkm-4/>

²⁹ <https://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2020/01/vendim-2019-12-24-864.pdf>

VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Ky **Vendim**³⁰ përcakton procedurat për identifikimin, mbrojtjen dhe reabilitimin e viktimave të trafikimit, si dhe institucionet përgjegjëse për reagimin e koordinuar për mbrojtjen dhe adresimin e nevojave të viktimave të trafikimit.

VKM

Nr. 499, datë 29.08.2018,

“Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Në këtë pjesë po fokusohemi vetëm në rastin kur punonjësi social i Bashkisë/njesisë administrative ka përgjegjësi specifike.

Vendimi ka rëndësi të njihet/konsultohet nga punonjësi social për të qartësuar rolet dhe funksionet e të gjithë institucioneve që janë pjesë e mekanizmit të reagimit që ngre VKM në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

Në fokusin e punës së punonjësit social janë veçanërisht:

Në faqen 38 të Vendimit sqarohen në mënyrë të detajuar **hapat që duhet të ndjekë punonjësi social të Bashkisë/njesisë administrative në funksion të identifikimit dhe reagimit fillestar** të një të rrituri viktimë trafikimi ose viktimë e mundshme trafikimit. Në cdo hap përcaktohen dhe tipet e formularëve që duhet të plotësohen që gjenden në anekset e Vendimit.

Gjithashtu të rëndësishme në këtë Vendim në këndvështrimin e punës së punonjësit social janë edhe **procedurat që ndiqen për planifikimin për mbështetje dhe riintegrim që jepen në mënyrë të detajuar në faqen 59 të Vendimit.**

MOSDISKRIMINIMI DHE TË DHËNAT PERSONALE

Qëllimi i këtij **ligji**³¹ është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe

LIGJ

Nr. 10221, Datë 4.2.2010

“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

30 <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20127/VKM%20nr.%20499,%20date%2029.8.2018.pdf>

31 <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/128-ligj-nr-10-221-date-4-2-2010-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi1-1>

mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim

Njohja e ligjit nga punonjësi social e ndihmon që të ketë një pamje të qartë të kuptimit të diskriminimit, institucioneve që kanë role dhe përgjegjësi për ndalimin e diskriminimit në tërësi.

Për nevoja të punës së punonjësit social ka rëndësi njohja dhe zbatimi i **Kreut IV: Ndalimi i diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve.**

Ky **ligj**³² ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Njohja e ligjit është e rëndësishme për punonjësin social, pasi ***gjatë menaxhimit të rasteve sociale do ti duhet të përpunojë të dhëna personale e për rrjedhojë duhet të respektojë detyrimet ligjore në këtë drejtim.***

Në mënyrë të veçantë janë të rëndësishme: Neni 5 : mbrojtja e të dhënave personale; Neni 6 : kriteret ligjore për përpunimin; Neni 7: përpunimi i të dhënave sensitive ; Neni 8 dhe 9: transferimi ndërkombëtar i të dhënave; Kreu IV : të drejtat e subjektit të të dhënave; Kreu V: detyrimet e kontrolluesi dhe të përpunuesit. Kreu VII: siguria e të dhënave personale

LIGJ

Nr. 9887, Datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin 120/2014

“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

³² https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Ligj_Nr.9887_dat%C3%AB_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf

